



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 76

Datë: 08. 11. 2021. Ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Gordana Llaban, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 67 dhe 68/2021.
- 2. Njoftim lidhur me vendimet e PZAP-së, të dorëzuara në KQZ me Aktin përcjellës, nr.2991/2021, të datës 07.11.2021, lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në kutitë e votimit për zgjedhjet lokale 2021.**
- 3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**
- 4. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
 - Shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve për Raundin e Dytë të zgjedhjeve lokale 2021.

5. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi i Rekomandimit për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për dorëheqjen e anëtarëve të Kuvendit Komunal të zgjedhjeve lokale 2021.

6. Të ndryshme.

1. Hyrje z.Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi : E hapim mbledhjen e 76-të të KQZ-së sipas rendit të ditës që keni para vetes. A ka dikush diçka lidhur me rendin e ditës për të shtuar, për të plotësuar...? Urdhëro z. Stollaj?

Fazli Stollaj: Në qoftë se bën vetëm një njoftim të shkurtë në fund lidhur me aktivitetet e Këshillit për Mbikëqyrje të Informimit Publik

Florian Dushi: Atëherë te pika e pestë raporti i këshillave, e kemi pikën e dytë shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për dorëheqjen e anëtarëve të kuvendit komunal zgjedhjet lokale 2021 propozojmë që të shtyhet në një mbledhje të radhës për shkak se ne kemi pranuar dorëheqjet të tashmë kryetarëve të komunave në disa raste dhe në disa kandidatëve të tjerë të cilët kanë kërkuar që të tërhiqen nga asamblatë komunale ku janë zgjedhur por meqë nuk i kemi akoma emrat e gatshëm me cilët do të zëvendësohen ne nuk i kemi sjellë në KQZ kjo mbetet për një prej mbledhjeve të radhës...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, me këto ndryshime kush është për këtë rend të ditës ?Me 10 vota për miratohet rendi i ditës.

Vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin e procesverbaleve 67 dhe 68, i kemi parë procesverbalet ne imellë, a ka dikush diçka lidhur me këto procesverbale? Kush është për miratimin e këtyre dy procesverbaleve ?

Me 10 vota për miratohen procesverbalet 67 dhe 68 të KQZ-së.

2.Njoftim lidhur me vendimet e PZAP-së, të dorëzuara në KQZ me Aktin përcjellës, nr.2991/2021, të datës 07.11.2021, lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në kutitë e votimit për zgjedhjet lokale 2021:

Burim Ahmetaj: Me datën 7 nëntor, kemi pranuar në imell të gjitha vendimet për të cilat PZAP ka marrë vendim dhe në bazë të cilave urdhërohet KQZ që të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve në shumicën e rasteve. Bëhet fjalë për rinumërimin e fletëvotimeve për kandidatë të subjekteve të ndryshme në komuna të ndryshme dhe në vendvotime të ndryshme. Sekretariati, është munduar të ekstraktojë të gjitha ato vendime të PZAP-së dhe ti grumbullojë në një tabelë e cila nuk mund të konsiderohet finale për arsye se jemi në pritje të tabelës finale nga PZAP dhe pas krahasimeve do të mund ta kemi finale mirëpo e kemi tabelën preliminare e cila është e formatuar në atë mënyrë që është renditur në bazë të vendimeve të PZAP- së.

Nëse shikoni tabelën, janë të gjitha vendimet e PZAP-së, është vendvotimi për të cilin bëhet fjalë nga komuna përkatëse dhe subjekti si dhe kandidatët dhe kolona e parafundit është edhe pjesa e vendimmarrjes ku urdhërohet KQZ që në shumicën e rasteve të bëhet rinumërimi për fletëvotimet e subjekteve politike përkatësisht për kandidatët; nëse mund të shihni tek kolona e fundit që është me koment në disa raste PZAP i është referuar vetëm qendrës së votimit që nënkupton që duhet të rinumërohet të gjitha fletëvotimet për kandidatë për të gjitha ato vendvotime të asaj qendre të votimit dhe në kolonë janë të specifikuar se sa fletëvotime i takojnë këtij vendvotimi.

Mirëpo, edhe nga praktikat edhe nga ajo se çka mund të dalë nga ky proces i rinumërimit mund të hasim edhe në probleme të ndryshme gjatë rrugës ku në rast se rinumërohen fletëvotimet për një kandidat në një vendvotim të caktuar pas rinumërimit mund të kemi edhe mospërputhje të votave të përgjithshme brenda subjektit ... kështu që në këtë rast rekomandojmë që ti jepet mundësia QNR-së të rinumërojë votat për atë subjekt në tërësi dhe kemi edhe raste ku mund të jenë fletëvotime që i takojnë ndonjë subjekti tjetër edhe në këtë rast të mund të rinumërohen fletëvotimet për ato dy subjekte, në mënyrë që të dalë rezultati i saktë.

Në total, në këtë listë preliminare bëhet fjalë për 448 vendvotime të rregullta , për 12 kutia të votimit të dengjeve të votave me postë dhe 18 kutia të votimit të dengjeve të fletëvotimeve me kusht pra në total janë 478 kuti të votimit ku duhet të rinumërohen fletëvotimet për shumicën e rasteve

Sami Kurteshi: Sigurisht, këtu ka shumë hollësi, detaje që është problem për ti shqyrtuar por unë e pash dhe kjo është relativisht shqetësuese. Po filloj nga ajo ana pozitive e rekomandimeve; unë mendoj se pjesërisht rekomandimi i sekretariatit është në rregull që të numërohet fletëvotimet gjithë anëtarëve ose

të subjektit. Unë mendoj se gjitha votat janë në relacion d.m.th., nuk ka votë vetvetiu prandaj, unë mendoj se gjithë këto vendvotime duhet të numërohen të plotë që të hiqet çdo mundësi e një ankesë tjetër sepse kur është rinumërimi i plotë nuk është e mundur edhe një ankesë tjetër sepse në të njëjtën kuti mund të bëjë dikush një ankesë pastaj të thotë edhe të miat nuk janë në rregull në të njëjtin vendvotim. Prandaj, unë propozoj që nëse hapet një kuti, atëherë edhe për një kandidat, numërimi është shumë më i vështirë se aty nuk është emri por vetëm numri; është problem kështu numërohet e tërë kutia dhe mundësia e një ankesë të dytë nga ndonjë kandidat tjetër pushon. Dhe çështja tjetër që mua po më shqetëson shumë me këtë numër të vendvotimeve edhe të rinumërimit edhe me rinumërimi që janë bërë deri më tani po del një numër relativisht i madh i vendvotimeve të rinumëruara.

Unë, këtu e pash edhe një tabelë që e kanë dërguar për raportin final të trajnimit për raundin e dytë të zgjedhjeve edhe unë e kam një pyetje që po më shqetëson mua; këtu kemi numri i anëtarëve që nuk kaluan testin e vlerësimit gjithkund është zero d.m.th., krejt trajnimit, të gjithë komisionerët e kanë kaluar testimin, asnjë edhe në raundin e parë kishte ndonjë përjashtim të vogël por të gjithë e kanë kaluar trajnimin.

Kjo është një, ana tjetër është që ne po na dalin dikund rreth 800 vendvotime përafërsisht, 700, 800 apo 900 që po duhet ti rinumërojnë, janë me mangësi! Tash, shtrohet pyetja: çfarë nuk është në rregull nëse të gjithë këta njerëz kalojnë trajnimin? A është në rregull ata i dinë të gjitha procedurat, këndeje na dalin rreth 35-40 % të vendvotimeve me mangësi? Nuk është diçka në rregull me trajnimin apo nuk është në rregull me testimin, apo kemi edhe ndonjë problem të ndonjë natyre tjetër se nëse të gjithë këta e kalojnë trajnimin të suksesshme, shtrohet pyetja se, mos po i bëjnë këto manipulime apo lëshime në mënyrë të qëllimshme ?

Nëse ata e kanë kaluar trajnimin, i njohin procedurat gjithçka është në rregull kurse, kemi 40 % në numërimi. Kjo, e vë në dyshim të gjithë procesin e trajnimit dhe angazhimit: komisionarët janë të deleguar nga subjektet politike dhe vëzhguesit po ashtu të gjithë e kalojnë trajnimin: pse ne i kemi 40 % në rinumërim ?

Alim Rama: Në lidhje me vendimet e PZAP, ato janë të qarta dhe unë mendoj që votat, të gjitha votat në kuti në qoftë se PZAP-i ka qenë e bindur se bile së paku për një kandidat, e ne e kemi rastin në Obiliq: të gjitha votat janë brenda dhe ato të gjitha pastaj duhet me u përputh kështu që, edhe unë kisha shkuar me rekomandim që pasi të hapet kutia, në qoftë se votat e atij kandidatit nuk janë në dengun e subjektit, atëherë ato mundën me u ndodh dikund tjetër..!

Ilir Gashi: Parimisht, nuk do të isha kundër në qoftë se edhe rinumërohen të gjitha votat kur hapet një kuti por duhet të kemi parasysh faktin në qoftë se jemi në rregull edhe me procedurë edhe në harmoni me vendimet e PZAP-it; PZAP ka marrë vendimin se çfarë duhet të bëj KQZ, në këtë rast dhe QNR. Ne, kemi shpallur një rezultat, është fakt se paraprakisht, para se me shpallë rezultatet ne kemi marrë vendime dhe jemi dakorduar të gjithë që të rinumërohen për të gjitha subjektet politike por, ajo ka qenë para se ne me shpallë rezultat dhe jemi para një akti kur ne kemi një rezultat të shpallur zyrtarisht për të gjithë kandidatët dhe subjektet politike...!

Tash, dilema është se çka nëse ne e hapim një kuti për të cilën ose numërojmë për x subjektin politik në qoftë se nuk ka ankesë dhe për kandidatët për të cilët nuk ka ankesa për ta? A e kuptoj faktin që mund të ketë mospërputhje por duhet që vendimi ynë të jetë fleksibil në raport me sekretariatit dhe QNR-në që në rast se paraqiten defekte ku ka mospërputhje të votave të kandidatit dhe të subjektit politik, problemi është brenda llojit dhe jo nuk mundet me u gjet...Janë raste shumë të rralla por, edhe që ndodhë që një votë të gjendet nga një subjekt të një subjekt tjetër; por edhe ajo krijon mospërputhje dhe në këtë rast, do të duhej të kemi një rinumërim të tërësishëm të asaj kutie votimi por, vetëm dilemën e kam a mund ne të rinumërojmë rezultat të cilën e kemi shpallur dhe për të cilën PZAP nuk ka dhënë një vendim të tij, parimisht jemi që të kemi një rezultat sa më të qartë dhe më të besueshëm për kandidatët; por nuk e di nuk e kam të qartë në qoftë se ne mund të hapim kuti, mund të rinumërojmë vota për të cilat veç, e kemi shpallur një rezultat dhe presim vetëm certifikimin i cili vije pastaj certifikimi, shkon pas përfundimit të afateve, ankimeve dhe shkon në PZAP tash apo më vonë në Gjykatën Supreme, parimisht, po them prapë nuk jam kundër edhe nëse i hapim të gjitha por, nuk e di nëse jemi në rregull me procedura dhe mos po dalim jashtë vendimeve të PZAP-it...

Ibrahim Selmanaj: Ne, veç morëm vendimin e PZAP-së rreth ankesave që i kanë parashtruar edhe kandidatët e zgjedhur në asamblëtë ose kuvendet komonale, e të njëjtën kohë edhe nga subjektet politike. PZAP, është bazuar edhe në informatat që i ka në terren por edhe mbi faktet, të gjeturat dhe ka sjellë një rezultat që ne e kemi para vetes. Unë, veç po e bëj një krahasim se në Podujevë një numër i madh i vendvotimeve do të shkojë në rinumërim; këtë radhë do të rinumërohen votat e të gjithë kandidatëve të subjekteve politike të cilat edhe kanë kërkuar që të rinumërohen vendvotimet; besoj që edhe në vendvotimet tjera në të cilat kandidatët kanë ankesat e veta duhet të bëhet rinumërimi i të gjithë kandidatëve në mënyrë që të kemi një rezultat të saktë edhe të qartë unë mbështes të drejtën se rinumërimi i votave z.Gashi sigurisht se ka të drejtë se bazohet në ligjet edhe në vendimet që PZAP i ka vendosur ndoshta edhe ligji është fajtor për formën që bëjmë organizimin e zgjedhjeve, ndoshta për faktin

që komisionerët që nuk i kemi krejt më të përgaditurit se po e sjellim rezultatin...! Po e shohim përfundimisht se duhet të shkojmë të rinumërimi por, rinumërimi sjell fakte, pastron gjendjen të cilën ne e kemi...

Florian Dushi: E para, unë konsideroj që si KQZ ne sipas gjitha gjasave nuk jemi të gatshëm të diskutojmë dhe të vendosim për këtë çështje me që nuk e kemi listën finale të vendotimeve. Këtu u tha se kemi një listë preliminare para nesh por, megjithatë unë nuk jam që të marrim vendim me listë preliminare! Ne, duhet të kemi listën përfundimtare të të gjitha qendrave apo vendotimeve për të cilat PZAP-i ka sjellur një vendim dhe pastaj ne të urdhërojmë QNR-në që të zhvillojë rinumërimin mbi bazën e vendimeve të PZAP-it; çështja tjetër u tha këtu që praktikisht është shqetësues numri i vendotimeve të cilat ne po detyrohemi ti rinumërojmë mbi bazën e të gjeturave tona ose mbi bazën e PZAP-së dhe vërtetë ky numër është shqetësues nuk ka dyshim por megjithatë, ky është legjislacioni në fuqi sipas të cilit ne jemi të detyruar që numërimin e votave t'ia besojmë të nominuarëve të subjekteve politike dhe atë këtë numërim ta zhvillojnë në vendotime.

Kjo, nuk është hera e parë që ne ballafaqohemi me një rinumërim të këtyre përmasave dhe besoj që nuk do të jetë as hera e fundit derisa nuk do të kemi ndryshime të cilat do të evitonin këtë formë të numërimit të votave në vendotime...

Nuk ka të bëjë, besoj unë, as me trajnimin, as me aspekte tjera thjeshtë, ka të bëjë me vullnetin e këtyre njerëzve dhe ka të bëjë kryesisht me manipulim klasik të votave të kandidatëve prandaj, të njëjtit sikur edhe në herave të kaluara;ne duhet të përpilojmë lista dhe t'ia drejtojmë organeve kompetente të drejtësisë që të merren me këta persona të cilët në fakt duke vepruar në këtë formë pavarësisht korrektimit që i bëhet procesit nga ana e PZAP-it ose, nga ana jonë megjithatë procesin zgjedhor procesin të cilin e kemi vlerësuar si të mirë në kuptimin e përshkrimit të pasaktë të votave të kandidatëve. Kur jemi te idea në qoftë se duhet të rinumërohen të gjitha ose do të duhet të rinumërohen vetëm pjesërisht, unë mendoj që në rend dite kemi njoftimin me vendimet e PZAP-së. Në anën tjetër, sipas ligjit në fuqi, ne jemi të detyruar që të veprojmë sipas vendimeve të këtij paneli.

Sa i përket KQZ-së , ne kemi shpallur rezultatet dhe kemi konsideruar që mbi bazën e asaj çfarë është punuar në QNR gjitha këto kanë qenë në rregull , ne kemi këto vendime të PZAP-së por nuk jemi edhe më tutje të sigurtë nëse rinumërimi do të prodhojë ndryshime dhe në çfarë niveli do të jenë ato ndryshime të cilat do ti prodhojë ky rinumërim prandaj unë konsideroj që në këtë fazë dhe me këtë pikë të rendit të ditës ne nuk mund të dalim jashtë kërkesës së PZAP; me që fjala është për implementimin e një vendimi

të një organi për të cilin ne jemi të detyruar ta zbatojmë prandaj çështjet duhet ti ndajmë nëse flasim për vullnetin e mirë të secilit prej nesh këtu unë nuk dyshoj që vullneti te secili prej nesh ekziston që e vërteta po e quaj në këtë formë e vërteta e votave të kandidatëve dhe të subjekteve politike brenda kutisë së votimit të zbardhet deri në fund por, kjo ka mundur të bëhet edhe më parë mund të bëhet edhe pas vendimit ose pas rinumërimit i cili po zhvillohet mbi bazën e urdhëresës të PZAP-së. Megjithatë, unë konsideroj që në këtë fazë ne duhet ti përmbahemi vetëm vendimeve të PZAP-së dhe të rinumërojmë ashtu siç ka kërkuar në disa raste vetëm për një kandidat të vetëm, në disa raste të gjitha fletëvotimet të cilat gjenden në kutinë e votimit, përndryshe ne do të biem në kundërshtim me vetëveten për shkak se këto rezultate njëherë si të tilla, i kemi shpallur prandaj unë mendoj nëse pas rinumërimit që ne e kemi zhvilluar të mbi 300 kutive të votimit, pas rinumërimit i cili do të zhvillohet sipas urdhëresës të PZAP-së dhe pasi të shohim se çfarë do të prodhojë ky rinumërim...

Alim Rama: Të gjithë ne, pajtohemi që ta zbatojmë vendimin e PZAP-it, çka fola unë më herët për lidhje se si të operacionalizohet ky vendim; unë mendoj që është e pamundur të sigurohemi që të gjitha votat e një kandidati; i kemi gati në listën e 478 i kemi gati të gjitha subjektet dhe kemi së paku një kandidat të secilit subjekt është e pamundur që të sigurohemi që ai kandidat i ka të gjitha ato votat aty, si ka pretenduar edhe e ka bindur PZAP-në pasi ka marrë këtë vendim që ne të kufizohemi gjatë verifikimit vetëm në dengun e atij subjekti; për të qenë të sigurohemi që kandidati ka dëshmuar në PZAP dhe PZAP ka marrë vendim që të rinumërohen votat për atë kandidat, e vetmja mënyrë është që të rinumërohen...

Sami Kurteshi: Pyetja ime është konkrete: a ka bërë sekretariati ndonjë analizë të vendimeve të PZAP-së edhe të bëj krahasimin e vendvotimeve që janë urdhëruar për numërim dhe në kuadër të këtyre vendvotimeve që janë urdhëruar për rinumërim ? A ka ndonjë vendvotim që ne veç e kemi audituar, e kemi rinumëruar edhe është në rregull sepse unë mendoj se nëse numërohen votat të vetëm një kandidati nuk e përjashtoj mundësinë e ankesave për të njëjtën kuti nga kandidatët tjerë dhe, ne do të duhet të bëjmë një punë të dyfishtë; kutia hapet formularët duhet të bëhen të ri si për të gjithë kutinë si për një kandidat, formulari është i ri nuk është më i njëjti; PZAP ka thënë unë dua ti kem votat e një kandidati por nuk ka vota që nuk ka relacion me kandidatë tjerë ose subjekti tjetër; PZAP nuk ka thënë mos i verifikoni ky kandidat është ankuar ne kemi dëshminë...

Unë nuk besoj që vendimi i PZAP-së përjashton mundësinë e rinumërimit të gjithë kutisë se edhe ashtu hapet kutia ashtu bëhen formularë të rinjë, dhe ashtu kanë për të dalur numra të rinj për ta shterur mundësinë e ankesës për të njëjtën kuti të njëjtin vendvotim. Prandaj, unë jam që e tërë kutia të rinumërohet edhe nxjerrën rezultate edhe të kandidatit veçanërisht të kandidatit ku theksohet se te ky

kandidat kemi këtë mirëpo unë jam i bindur se në qoftë se ka lëvizje, ajo prek kandidatë tjerë dhe subjekte tjera. Pyetja ime ishte se, a keni bërë ndonjë analizë të këtyre vendvotimeve që ka kërkuar PZAP me i rinumërua edhe të atyre që ne i kemi verifikuar me rinumërim në QNR ?

Burim Ahmetaj: Sekretariati, ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me PZAP –në dhe para se të filloj i gjithë procesi i ankesave i ka deponuar në PZAP të gjitha vendvotimet të cilat janë rinumëruar nga KQZ dhe të njëjtat nuk janë përfshirë në këtë tabelë d.m.th., nuk përmbajnë vendvotime të cilat janë paraprakisht të rinumëruara në bazë të vendimit të KQZ-së. Më lejoni të bëj edhe një sqarim të shkurtër sepse kjo tabelë të cilën e keni para vetes e kemi ekstraktuar e kemi nxjerrë nga të gjitha vendimet e PZAP-së , ju konfirmoj se i kemi të gjitha vendimet që i kemi dërguar në imellë ditën e djeshme te KQZ-ja dhe për këtë arsye që e kemi përpunuar vetë; e kemi ekstraktuar nga vendimet mund të jetë ndoshta edhe ndonjë lëshim përndryshe vendimet i kemi të gjitha nga PZAP-ja dhe në bazë të atyre vendimeve obligohemi që të veprojmë mirëpo, që e thash edhe më herët në të gjitha këto raste kur kërkohet rinumërimi i fletëvotimeve për kandidatë përveç në ato raste kur mund të ketë mospërputhje pas rinumërimit atëherë sugjerimi është që të rinumërohen votat për subjektin politik të gjitha votat e atij subjekti politik për shkak të mospërputhjes së fletëvotimeve dhe në ato raste kur mund të gjendet një fletëvotim nga ndonjë subjekt tjetër...

Në të gjitha këto raste, do të na duhet leja e KQZ –së që të rinumërohen brenda atij subjekti

Ilir Gashi: Po mendoj që në bazë të vendimit që ne mund ta nxjerrim mund të specifikojmë edhe çështje që mund të dalin në proces të rinumërimit ne mund të udhëzojmë se vetëm duhet të respektojmë vendimin e PZAP-së edhe ta udhëzojmë QNR-në të filloj procesin në bazë të vendimit në qoftë se del diçka tjetër nga ajo çka gjendet në kuti ose çfarë është thënë në vendimin e PZAP-së; atëherë ose mund të vijë me rekomandim të ri QNR-ja ose ne mund tani në vendim mundësinë sepse e dimë faktin se në qoftes e pas rinumërimit ndikon në rezultat në renditje atëherë patjetër që duhet me e rinumëru votat e të gjithë kandidatëve të atij subjekti politik se, mund edhe ta ndryshojë rinumërimi renditjen e kandidatëve të atyre që kanë fituar me hy brenda ose me dalë por nuk mund të paragjykojmë një të gjetur të tillë. Unë, dilemën vetëm e kam që ne e kemi shpallur rezultat dhe nuk mund të rikthehem mbrapa për ta rinumëruar diçka që e kemi shpallur zyrtarisht d.m.th., çështjen e vendimmarrjes ne, e kemi shpallur rezultatin për kandidatë dhe e di secili subjekt politik e di numrin e kandidatëve në asamble dhe kush janë ata, ata i kemi shpallur ne presim vetëm certifikimin pa dashur të paragjykoj atë që gjendet në kuti. Mendoj që QNR duhet të fillojë me procedurën e vet të rinumërimit në bazë të vendimeve të PZAP-së...

Sami Kurteshi: Unë nuk po e kuptoj logjikën d.m.th., se e tha edhe z. Gashi nuk po dua për polemikë nëse na dalin mospërputhje mandej e rinumërojmë të gjithë vendvotimin; këtu edhe e kam problemin pse me i hy një punë dy herë kur ti ke për ta hapur një vendvotim, një kuti ke me i rinumërua ke me i nxjerrë ato - ato çfarëdo mungese të votave të kandidatit ka të bëjë me votat e kandidatit tjetër ose subjektit tjetër; edhe të themi se për “Sami Kurteshin” mungojnë 5 vota ose i ka tepër 5 vota por që ato 5 vota ia ka marrë “z. Rama” dhe, përsëri ndryshon...Këtu, unë e kam problemin. PZAP nuk e ndalon këtë, ne i kemi shpallur rezultatet, por nuk i kemi certifikuar...

Pyetja ime konkrete ishte për z. Ahmetaj por ai nuk u përgjigj krejt konkret. Pa, z. Ahmetaj, a ka ndonjë ankesë për ndonjë vendvotim që PZAP e ka menduar se duhet të rinumërohet por, e ka marrë si të mirëqenë rinumërimin d.m.th., përgjigjen e KQZ-së pas rinumërimit të asaj kutie...?

Ibrahim Selmanaj: Unë, e kam edhe një pyetje sqaruese por edhe si dilemë: një kandidat i cili ka parashtruar ankesën edhe shihet se është pranuar ankesa si e tillë, dhe po supozojmë se kanë munguar 17 ose 20 vota edhe për atë nuk ka hyrë që të jetë asamblistë; tash i dalin ato 17 vota e duhet të hiqet dikush tjetër, këtij ju kanë numëruar votat por supozojmë numri 9 ky hyn, del ai tjetri që nuk ju kanë rinumëruar votat, hapet e drejta e këtij me e kontestua dhe na zgjatet neve procesi...A e kam sqaruar mirë...?

Burim Ahmetaj: Ne, e kemi deponuar listën edhe në baze të atyre e kane marr si të mirëqena PZAP-i dhe ka konsideruar së për këtë vendvotime apo për vendvotimin e caktuar është bere rinumërimi dhe praktikisht është refuzuar ankesa e ankuesit. Mirëpo sa i përket të drejtës së ankesës të drejtën e ankesës e ka gjithsecili mirëpo ne po flasim për një numër të vendvotimeve ku një kandidate mund të ketë ankesën më shumë se 10 apo 12 vendvotime edhe kur mbledhtë totali i të gjitha votave pastaj do të del rezultati. Pra, këto rezultate që dalin pas rinumërimit sipas vendimit të PZAP-it që thotë rinumërohen fletëvotimet për këtë kandidate për këtë subjekt politike në këtë vendvotime atëherë këto rezultate konsiderohen finale dhe sigurisht që rezultatet të cilat konsiderohen finale përfshihen rezultatet përfundimtare ndoshta edhe mund të ndërrojnë gjendjen ne e kemi vetëm dilemën që na duhet përkrahja e KQZ-së në rastet kur subjekti i ka 10 vota dhe gjithë kandidatet i kane pasur para rinumërim 10 vota por tani më rinumërimin e një kandidatit e kemi 11 apo 12 vota neve do të na duhet leja e komisionit qendrore të zgjedhjeve që fletëvotimet e atij subjekti politike të rinumërohen mënyre që të jene të sakta rezultatet brenda subjektit...

Florian Dushi: Prapë, po them duhet më e nda edhe at në mënyre sa më të qarte të mundshme vullnetin e mire idetë e mira prej asaj për çka jemi të obliguar më kushtetute ligj dhe më rregullat tona si akte të brendshme të këtij institucionit ne mund të kemi ide, vullnetin e mire pa kufi por megjithatë dispozitat ligjore të cilat na kufizojnë për më marr vendime të caktuara në momente caktuara dhe rrethana të caktuara; unë e kuptoj idenë dhe unë e di që është zhvilluar edhe të kaluarën pavarësisht vendimeve kur është hap kutia është rinumëruar e tera dhe e kuptoj idenë dhe logjiken e asaj së çfarë po thuhet këtu sepse ne tani kishim tek një rinumërim që ndodhi, një rinumërim mandej që ka qene më i përlururi në Kosovë kur vota e një kandidati është gjete tek kandidati tjetër dhe mos të i kishim rinumëruar të gjitha votat...?

Ne, nuk kishim konstatuar më rinumërimin e dengut të votimeve të një kandidatit asgjë, sepse ato vota kane dal si të tilla por kur i kemi numëruar të tjerat e kemi gjete një vote andej dhe atij ju ka mundësuar një ju ka shtuar këtij do të thotë logjika e numërimit te gjitha fletëvotimeve është kjo prandaj, unë as nuk e gjykoje këtë si forme të korrektimit të procesit në një mase më të madhe tani edhe më këto 300 apo 400 kuti votimi; po kërkoje dy çështje prej sekretariatit: një më ma konfirmuar nëse është vepruar edhe të kaluarën kështu, dy, për sa kohe mundet më u zhvilluar ky proces i këtillë...?

Alim Rama: Unë, e kuptoj që ne s'jemi ngushte në zbatimin e vendimeve të PZAP-ës por sa do që jemi ngushte unë mendoj që është e pa mundur të realizohet e drejta te vendoset për një kuti në qofte se këqyren vetëm 5 fletëvotime ose 10 fletëvotime, e drejta përcaktohet vetëm nëse shikohen te gjitha fletëvotimet në kuti. Ajo e prodhon një rezultate të ri në cofte së ka më pasur një ndryshime vetëm një ndryshime është rezultate tjetër ndoshta vetëm të atij kandidatit që është ankuar kështu që unë e kuptoj ketë proces që nuk jemi ne ngushte për zbatimin, PZAP-ë e ka gjetur vetëm një gabime edhe ka thane konfirmomi votat për at candidate por s'mundemi ne më i konfirmuar votat për at candidate pa i shikuar të gjitha votat kështu që unë mendoj që vendimi që të rinumërohen komplet brenda kutive do behet formulari i ri i vetmi vendim që neve na lejon më zbatuar vendimin e PZAP-it, qoftë edhe për një kandidatë...

Ilir Gashi: Vendimin e kemi konfirmuar më votën tonë me shpalljen e rezultateve; çka ka në kuti ne e kemi konfirmuar por e kemi shpallur rezultatin dhe tjetra, çka nëse në një kuti është vetëm një ankesë për një kandidatë dhe votat e tij dalin në rregull 100% ? Cila është arsye me hi me i numëruar votat e tjera që i ke shpallur dhe pa vendim të PZAP-s ? Kryesues, unë publikisht e them që unë abstenoj nga një vendim i tillë...

Alim Rama: Unë mendoj që ne kemi vendosur më i shpall rezultatet në baze të informatave që kemi pasur në at moment d.m.th ne cofte se kemi njohurit të reja e ne më vazhduar më i certifikuar pavarësisht së nuk ka ndonjë vendim është një gabime shumë i madh unë mendoj që të gjithë ne kemi votuar më i shpall rezultatet përfundimtare në baze të informatave që i kemi në cofte se jemi në njohuri për një informate të re pavarësisht shkakut pse kemi ardhur deri tek ajo informate e re atëherë mendoj që ajo neve na qetë ma shumë në lajthitje se atëherë ne duhet më i certifikuar rezultatet e gabuara duke e ditur që nuk janë të sakta. Kështu që unë mendoj që e vetmja mënyre për mu zbatuar vendimi është të rinumërohen të gjitha fletëvotimet brenda në kuti sepse ai kandidatë ja ka dëshmuar PZAP-it që votat e tije nuk janë në rregull.

Burim Ahmetaj: Pas rinumërimit, ka mos përputhje të votave të subjektit më totalin e votave të kandidatëve të rinumërohen fletëvotimet vetëm për atë. Sipas vendimit të PZAP-it të gjitha rastet rinumërohen fletëvotimet për kandidatë siç është urdhëruar nga PZAP-ë përveç në ato raste ku mund të kemi mos përputhje pas rinumërimit të fletëvotimeve për kandidatë. E kemi edhe 3 konfirmime, konfirmojë se pas të gjitha atyre procedurave kane të drejt të ushtroje të drejtën e tyre në gjykatën supreme, për të gjithë palët e pa kënaqura. Praktike në të kaluarën ka pasur kur kemi rinumëruar fletëvotime vetëm për një kandidatë sipas kërkesës apo sipas vendimit të PZAP-ës, varësisht si ka kërkuar PZAP-i kemi rinumëruar në të kaluarën.

Kreshnik Radoniqi: Për cilën jeni a ka konsensus më numëruar të gjitha këto vendvotime apo më shkuar vetëm për subjektet politike. Atëherë shkojmë më vota kush është për?

Me nëntë vota për, dhe me një abstenim (Ilir Gashi) miratohet vendimi i PZAP-së për rinumërim në të gjitha vendvotimet, sipas këtij vendimi.

3.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi i Rekomandimit për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së

Kosovës:

Florian Dushi: Këshilli për çështje ligjore ka shqyrtuar sot kërkesën e Presidentes së Kosovës e cila është drejtuar KQZ-së më kërkesën që të evidentojë dhe të rekomandojë Presidentes emirin i cili do të zëvendësoj deputetin Fadil Nura i cili i cili është certifikuar nga ana e KQZ-së si kryetare i komunës së

Skenderajt. KQZ-ë përkatësisht sekretariati ka bere analizimin e renditjes së listës së PDK-së e cila ka dal nga zgjedhjet e 14 shkurtit të këtij viti dhe sipas kësaj rend dite presidentes do të i rekomandohet që deputeti Fadil Nura aktualisht kryetare i Komunës së Skenderajt i certifikuar në baze të rezultateve të zgjedhjeve të 17 tetorit do të zëvendësohet me kandidatin vijues në listën e PDK-së më emirin Isak Shabani. Pra, ky është rekomandimi i këshillit për çështje ligjore për KQZ-ën dhe më tutje KQZ-ë duhet të i dërgoje emirin Presidentes së Kosovës për të zëvendësuar deputetin Fadil Nura, me deputetin z. Isak Shabani.

Kreshnike Radoniqi : Kush është për ? Me 10 vota për, i rekomandohet Presidentes që kandidatin e radhës më rastin e dorëheqjes së deputetit Fadil Nura, ta zëvendësoj me Isak Shabanin nga lista e subjektit politik PDK-ës.

4. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

Burim Ahmetaj: Më lejoni para së t'ju njoftojë më aktivitetet e sekretariatit të ju njoftojë së krahas përgatitjeve të listës së vendvotimeve që duhet të rinumërohen QNR-ë ka bere të gjitha përgatitjet duke njoftuar edhe stafin po ashtu edhe vëzhguesit për fillimin e procesit të rinumërimit, rinumërimi fillon sot në ora 17:00. Më lejoni të ju njoftojë më aktivitetet e sekretariatit që jemi në vazhdimet e përgatitjeve për rundin e dyte për zgjedhje për kryetare komune, përgatitjet janë duke u bere për 21 komuna në të cilat do të organizohen zgjedhjet për rundin e dyte për kryetare komune ku do të jene vetëm dy kandidatet dhe sekretariati ka përgatitur të gjitha materialet të cilat do të shpërndahen neper komuna, pra materialet zgjedhore pra materialet zgjedhore janë materiale të ndjeshme të cilat presin më i shpërnda neper secilën komune më datën 10 dhe 11 Nëntor ndërsa materialet e ndjeshme siç janë fletëvotimet dhe lista përfundimtare e votuesve do të shpërndahen më datën 13 nëntori neper secilën komune.

Më lejoni te ju njoftojë se ka përfunduar procesi i shtypjes së fletëvotimeve dhe priten të arrin në depon qendrore të KQZ-ë më datën 10 nëntori pra do të arrijnë fletëvotimet për rundin e dyte. Krahas përgatitjeve tjera sekretariati është duke përgatitur edhe planin operacional për ditën e zgjedhjeve ku do të përfshihen një mori aktiviteteve mirëpo nder kryesoret më lejoni të theksoje angazhimin e zyrtareve komunal të cilët komunat e të cilëve nuk do të jene në rundin e dyte dhe të njëjtit do të i angazhojmë për të marr pjese apo për të monitoruar procesin në këto komuna ku organizohen zgjedhjet.

Tani, jemi në fazën e trajnimeve të këshillave të vendvotimeve dhe trajnimin e stafit te rezultateve preliminarë, procesi i trajnimit të stafit të rezultateve preliminare të cilët do të informojnë nga të gjitha qendrat e votimit nga 21 komuna fillon më datën 9 nëntori dhe pritet të kompletohet gjate ditës së

nesërme ndërsa trajnimi i anëtareve të këshillave të vendvotimeve ka filluar më datën 5 nëntor duke vazhduar më datën 6,7 dhe pritet në ditët në vazhdim priten të kryhen të gjitha trajnimet të këshillave të vendvotimeve përfshirë edhe zëvendësimet dhe plotësimet pas vendimit të KQZ-ë. Në raport e keni edhe sa seanca të trajnimit janë zhvilluar deri më tani ku janë zhvilluar gjithsejtë 161 seanca të trajnimit për procedura të trajnimit dhe numërimit pra të ndare në 79 ekipe në 16 komuna të ndryshme ka filluar procesi i trajnimit dhe pritet edhe në komuna tjera.

Më lejoni të ju njoftoj po ashtu edhe më ekipet mobile të cilat KQZ-ë përkatësisht sekretariati ka punuar në teren në mënyrë që të identifikojë të gjithë votuesit personat më nevojat të veçanta dhe personat të infektuar më covid 19 pra në këto zgjedhje lokale do të jene gjithsej 110 ekipe mobile ku prej tyre 80 ekipe do të jene në dispozicione të votuesve të personave më nevojat të veçanta dhe 30 ekipe do të jene në dispozicione për të ofruar votimin personave të cilët janë të infektuar më covid. Për ndryshe sekretariati është në procesin e zëvendësimeve dhe plotësimeve të anëtareve të këshillave të vendvotimeve sipas vendimit të KQZ-së .

Sami Kurteshi: Unë kam dy çështje: njëren vetëm e përmenda të kjo çështja e trajnimit d.m.th edhe të kualifikimit të gjithë komisioneve, unë jam i disponuar që një here KQZ-ë të shohë cila është mënyra e testimit të komisionarëve. Më gjitha këto rinumërimet unë jam i shqetësuar me krejt sistemin e trajnimit kjo është çështja e parë. Çështja e dytë: ne kemi marr një vendim për regjistrimin e personave më nevojat të veçanta që zgjate afati deri nesër me datën 9, unë kam pas personalisht ankesa nga Gjakova edhe nga Gjilani sepse zyrtaret komunal i refuzojnë njerëzit ku shkojnë edhe më gjithë vendimin e KQZ-së me i pranuar dokumentet. Kërkesa ime është që nga sekretariati i KQZ-së të krijohet një protokoll që kur merren vendime të KQZ-së lidhje më këto çështje që prekin edhe zyrtaret komunal që vendimi të ju dërgohet njëkohësisht atyre dhe anëtareve të KQZ-së dhe të publikohen ato vendime menjëherë në faqet e KQZ-së.

Unë, e kam edhe një çështje tjetër që nuk është pjese e raportimit nga takimet më komisionarë më shumë vëzhgues edhe më shumë njerëz po del një problem që e ka përmend edhe kolegu Cemajl Kurtishi lidhur më përdorimin e telefonave në ditën e zgjedhjeve ne si KQZ-ë unë mendoj që ne si KQZ-ë duhet të mendojmë një mënyrë të ndalimit dhe rreptësimin të vendimit për mos përdorimin e telefonave për fotografimin e votës ditën e zgjedhjeve, e kemi diskutuar por asnjëherë s' kemi marr vendim si duhet të operacionalizohet ajo çështje. Fotografimi i votës, është rreptësisht i ndaluar....

Alim Rama: Trajnerët e angazhuar nga KQZ-ë dalin kundër vendimit dhe kundër rregullave të KQZ-së dhe unë mendoj që është një faktë shqetësueses që trajnerët ndërhyjnë ose shtjellojnë inspektimin e kësaj kategorie sepse fotografimi i votës cenon lirin e votës. Ndoshta unë isha ndërlidhe më shumë për mbledhjen tjetër kurdo që të jetë gati sekretariati votimi më asistence është një kategori që KQZ-ë jua ofroni të gjithë atyre që kane nevojë për asistence mu po më kujtohet një prej analizave që kemi trajtuar vitin e kaluar kemi pasur rastin që një drejtor i shkollës s'po e përmendi komunën ka votuar më asistence unë kisha kërkuar nga sekretariati nesër ka kohe deri në ditën e zgjedhjeve që të i analizon të gjithë ato votime më asistence bile numrat edhe të mundohet të kontaktohet sepse votimi më asistence është po ashtu një prej mënyrave tjetra të presionit se për personat më nevoja të veçanta ne e kemi ekipet mobile për personat që nuk shohin e kemi formularët e të verbërve, për njerëzit që nuk mundën më qëndruar në këmbë ne e kemi edhe një kuti të votimit që personi mundet më u ul kështu që e kisha heke fare këtë kategori sepse, nuk ka mbet dikush tjetër fare me asistua.

Kjo, duhet të themi që kur është berë, o bërë për persona që s' kane mundur më qëndruar në këmb edhe personat që s' kane pa, ato dy probleme janë zgjedhe; votimi më asistence është një lloj presioni; ata që kane ble votën duan më u siguruar që vota shkon atu, edhe moment që dikush voton më presion vota nuk është e lire dhe është kundër kushtetues. Kështu që kisha kërkuar nga sekretariati më na bo një analize të votave më asistence sa më shpejt që të jemi në gjendje më marr një vendim...

Cemajl Kurtish: Shumë mirë Alimi e tha vetëm a po din njëherë ku po jeton Alimi, duhet më menduar njëherë ku po jeton edhe ku po jetojnë ata tjerët votimi më asistent është më i mire formule e votimit për votat ku jetoj unë po edhe më qindra katunde ku jeto asnjë s' din më votuar ajo që nuk shkoni më burrin ose më djalin kurrë s' ka më votuar edhe kurrë s' kanë më ditë ku më votuar unë jam kundër këtij një e dyta më telefon ne s'mundemi më ndaluar njerëz a telefonon a nuk telefonon ai është problem i tije.

Tjetër z. Samia që tha komisionarët çka më bo pse po dalin kështu; ata kenë marr vota qe kaq, askush nuk është fajtores ne si KQZ-ë nuk jemi fajtores fajtori është PZAP-i edhe gjyqi që ata po i fal duhet më i dënuar ne s' kemi gjyqtare këtu jemi anëtar të KQZ-së edhe ato ka kush më i shikuar e jo ne. Unë, jam më i dënuar ata komisionarët që janë atu unë kam pas disa here fjalimin më Alimin se po hynë të gjithë ata kapadai që ka dhanë besën për subjektin politike ose për parti të vete edhe unë ka më vjedh vota e ka më pru. Unë kom pas rastin disa ankesa në komunën e Lipjanit njeriu ka marr 180 vota kur e kane rinumëruar kane dal vetëm 35 vota. 150 vota s'janë kërkon e kush është fajtores ata komisioneve janë fajtores s'jemi ne...

Kreshnike Radoniqi: Faleminderit, kjo ndoshta mundet me u trajtuar edhe në KOZ-ë edhe pastaj atje e jepni edhe imputet edhe krejt...

Alim Rama: Vetëm i isha referuar në një emisione në rubikon ku jemi kane të tre anëtarët e KOZ-së 82% shtetaseve të Kosovës mendojnë që ka shite blerje të votës. Edhe mendoj që mjafton si dëshmi që është ajo bindja jashtë atje që ka shite blerje edhe momentin që ka shite blerje atëherë nuk ka liri të votës.

Kreshnike Radoniqi: Le të trajtohet kjo në KOZ-ë...

Burim Ahmetaj: E konfirmoj që nga fundi i javës se, do të përgatitem një raport preliminarë sa janë shifrat e votimit më asistence cilat janë arsyet edhe do të dërgojmë në KOZ-ë...

Kreshnike Radoniqi: atëherë po vazhdojmë më aktivitetet e zyrës. Z. Buleshkaj keni disa kërkesa për akreditim te vëzhguesve.

5. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve për Raundin e Dytë të zgjedhjeve lokale 2021:

Yll Buleshkaj: Kemi shqyrtuar ndërkohe të madhe të kërkesave, një numër i madhe i kërkesave është në plotësim nga subjektet politike të cilët kane pasur mungesa edhe deri sot kane pasur afate me plotësuar ndërsa për të rijnë po ashtu kane pasur afatin deri sot në ora 4 të dorëzojnë vëzhguesit e ri. Kemi katër kërkesa të cilat janë finalizuar ndërkohe dhe të cilat e kane plotësuar të gjitha kushtet dhe dokumentet për tu akredituar si vëzhgues...

- Misioni diplomatik i SHBA në Kosovë, ambasada e SHBA-ve në Prishtinë ka dorëzuar për akreditimin edhe dy vëzhguesve të cilët kane plotësuar të gjitha kërkesat dhe rekomandohet për akreditim.

Më 9 vota për Akreditohe.

- OJQ vendore qendra për politika dhe avukim ka sjell për 3 vëzhgues kërkesën e tyre të cilët po ashtu kane plotësuar të gjitha kriteret ligjore për tu akredituar dhe rekomandojmë që të aprovohet për akreditime.

Më 9 vota për Akreditohe.

- OJQ-ë tjetër vendore Instituti i Kosovës për demokraci ka bere ka paraqitur kërkesën e tyre për akreditimin e pese vëzhguesve shtese të tyre, të gjithë këta e vëzhgues i kane dorëzuar dokumentet e kërkuara dhe i plotësojnë kushtet për tu akredituar.

Më 9 vota për Akreditohe.

- Misioni vëzhgues Unioni Evropian në Kosovë e ka dorëzuar aplikacionin për akreditime edhe të një vëzhguesit shtese të tyre dhe rekomandojmë aprovimin e tij.

Më 9 vota për Akreditohe.

Si informate shtese, kemi pranuar raportin e auditimit të gjitha subjekteve politikë të cilat janë kthyer nga kontraktori i kontraktuar nga kuvendi i Kosovës jemi në proces të përgatitjes së pakove dhe dorëzimit të këtyre raporteve të auditimit të secilit subjekte politikë ndërkohe do të kërkohe edhe publikimi i tyre në ueb faqe e KQZ-së të njëjtën kohe do të përgatiten edhe rekomandimet për KQZ-ë për masa administrative për subjektet të cilat nuk kane zbatuar ligjet.....

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka tjetër ? Vazhdojmë me z. Stollaj.

6.Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik

Fazli Stollaj: Kështu siç është praktike për aktivitetet e këshillit për mbikëqyrje të informimit publike sot këshilli është takuar dhe ka miratuar 3 produkte të reja të cilat kane të bëjeni më informimin lidhur më votimin që do të behet më 14 nëntor. Behet fjale për videospotin motivues për të dal në votime më 14 nëntori, videospotin që jep udhëzime se si të votojnë ata të cilët janë të infektuar më covid 19, dhe videospotin që ka të beje më votimin më masa mbrojtës ndaj covid 19. D.m.th., me këto 3 produkte të fundit të miratuar të cilët, do të jen neper televizione dhe rrjete sociale po përmbillet ajo strategjia për informimin publike.

Kreshnike Radoniqi: Faleminderit, në të ndryshme a ka diçka? Jo, atëherë me kaq e përfundojmë mbledhjen shihemi në mbledhjet e radhës...

7. Të ndryshme !

